



DIP - SSEJ
Unité Vue et Ouïe (Njësia
Shikimi dhe Dëgjimi)
Rue des Glacis-de-Rive 11
1207 Genève

Prindërve të

Gjenevë, më

Zonjë, Zotëri, të dashur Prindër,

Para pak kohe, ne bëmë një depistim të çrregullimeve të shikimit në kuadrin shkollor. Ky kontroll duket se tregon që fëmija juaj nuk arrin të dallojë mirë disa ngjyra.

Shumica e njerëzve që kanë një anomali të shikimit të ngjyrave bëjnë një jetë krejt normale. Ndërkaq, në disa raste, ata mund të hasin në vështirësi në jetën e përditshme dhe në shkollë. Është e dobishme që fëmija juaj dhe ju vetë të jeni të informuar dhe është gjithashtu e rëndësishme që ju të vini në dijeni mësuesit, të cilët do të jenë kështu më të kujdesshëm ndaj nevojave të fëmijës suaj.

Nga ana tjetër, një anomali e shikimit të ngjyrave nuk mundëson zgjedhjen e disa profesioneve, të tilla si pilot avioni, drejtues treni, punonjës elektronik. Prandaj, do të jetë e nevojshme t'i bëni një kontroll më të saktë të shikimit të ngjyrave. Ky kontroll mund të bëhet qysh nga moshë njëmbëdhjetë vjeç.

Ne do të rimarrim kontakt me ju, kur fëmija juaj të ketë arritur moshën njëmbëdhjetë vjeç, për programimin e këtij kontrolli. Ne jemi në dispozicionin tuaj për t'ju dhënë çdo informacion plotësues të dobishëm.

Ju do të gjeni bashkëlidhur një kopje të kësaj letre, të cilën lutemi t'ia kaloni mjekut trajtues të fëmijës suaj.

Duke ju falënderuar për besimin tuaj, lutemi pranoni, Zonjë, Zotësi, të dashur Prindër, shprehjen e ndjenjave tona të shquara.

Dr MUNIER Alain
Mjek përgjegjës në oftalmologji,

CAFALLI Myriam
Teknik/e në audiologji dhe oftalmologji

Bashkëlidhur : kopje e letrës që duhet t'i dorëzohet mjekut trajtues